



PLOTËSIM
I URDHËRESAVE TARIFORE TË SHËRBIMIT TË UJIT
Taksat për Kycje
në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit

Duke marrë parasysh ankesat e caktuara të një numri të konsumatorëve të rij të cilët kërkojnë kycje në rrjetin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe mëdyshjeve që kanë dalë për pagesën e tillë e cila ka të bëjë me shërbimet e theksuara.

Si dhe duke marr parasysh faktin se një numër i caktuar konsumatorëve të rij e posaçërisht ata të zonave periferike dhe rurale të vendit të cilët mund të mos kenë shërbime për grumbullimin e ujërave të zeza nga furnizimi i konsumatorëve të tillë me shërbimet e ujësjellësit.

ZRRUM e ka parë të arsyeshme ti përshtat UTSH-ët e lëshuar me 31 dhjetor 2008, Shtojca 1. Lista e tarifave të shërbimit, pika 2. Taksa për shërbimet e kycjes, duke i ndarë këto dy shërbime si të veçanta nga njëra tjetra në proporcion 60:40 në favor të shërbimit të ujësjellësit të cilat i rikonfirmon edhe një herë në shumë të përgjithshme të taksës së tillë ekzistuese të përcaktuar me UTSH-ët e lart cekura për të gjitha KRU-të.

Taksa për Kycje në Shërbime*	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësi	Shuma (EURO)		
		Vetëm për shërbime të ujësjellësit	Vetëm për shërbime të kanalizimit	Për të dyja shërbimet
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) - Taksë e pakthyeshme e aplikueshme për kycje të reja në shërbime në sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit të ujërave të zeza.	(13 – 25) mm	30.00	20.00	50.00
	32 mm	90.00	60.00	150.00
	40 mm	150.00	100.00	250.00
	50 mm	240.00	160.00	400.00
	65 mm	300.00	200.00	500.00
	80 mm	420.00	280.00	700.00
	100 mm	570.00	380.00	950.00
	150 mm	840.00	560.00	1400.00

Tarifat e tilla të ndara për shërbime janë obliguese për aplikim për të gjitha KRU-të duke filluar nga 1 janari 2011 e tutje.

Prishtinë, 31 dhjetor 2010

Raif Prenen

Drejtor i ZRRUM